

VENDIM
Nr. 190, datë 5.4.2023

PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA PROJEKTI “RIKUALIFIKIM URBAN I LAGJES ‘LLUKAN PRIFTI’, BASHKIA KUÇOVË”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga projekti “Rikualifikimi urban i lagjes ‘Llukan Prifti’, Bashkia Kuçovë”.
 2. Shpronësimi bëhet në favor të Bashkisë Kuçovë.
 3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private, që shpronësohen, kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse, që paraqitet në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, për pasuritë e llojit “ndërtesë” dhe “ullishtë”, me një vlerë të përgjithshme prej 1 873 996 (një milion e tetëqind e shtatëdhjetë e tre mijë e nëntëqind e nëntëdhjetë e gjashtë) lekësh.
 4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, prej 1 873 996 (një milion e tetëqind e shtatëdhjetë e tre mijë e nëntëqind e nëntëdhjetë e gjashtë) lekësh, përballohet nga buxheti i Bashkisë Kuçovë.
 5. Vlera e shpenzimeve procedurale, në masën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, përballohet nga buxheti i Bashkisë Kuçovë.
 6. Shpronësimi fillon menjëherë pas botimit të këtij vendimi në Fletoren Zyrtare dhe afati i përfundimit të shpronësimit është brenda 3 (tre) muajve nga data e hyrjes në fuqi të tij.
 7. Pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private, të pasqyruar në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi kompensohen për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin justifikues për likuidim pranë Bashkisë Kuçovë.
 8. Bashkia Kuçovë kryen procedurat për likuidimin e pronarëve të shpronësuar, sipas përcaktimeve të bëra në këtë vendim.
 9. Afati i fillimit dhe i përfundimit të punimeve është në përputhje me afatet e parashikuara nga Bashkia Kuçovë.
 10. Agjencia Shtetërore e Kadastrës pezullon të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuar, deri në momentin e realizimit të procesit të hedhjes së gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale dhe regjistrimin e kalimit të pronësisë në favor të Bashkisë Kuçovë, për pasuritë e shpronësuar.
 11. Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Berat, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, nis procedurat për hedhjen e gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale, sipas planimetrisë së shpronësimit të miratuar, dhe regjistron kalimin e pronësisë për pasuritë e shpronësuar në favor të Bashkisë Kuçovë.
 12. Ngarkohen Bashkia Kuçovë, Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Berat dhe Agjencia Shtetërore për Shpronësimin për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

LISTA EMËRORE E PRONARËVE PASURITË E PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE E TË CILËVE PREKET NGA REALIZIMI I PROJEKTTIT “RIKUALIFIKIMI URBAN I LAGJES ‘LLUKAN PRIFTI’ BASHKIA KUÇOVË”

Nr.	PRONARI			TË DHËNA KADASTRALE									VLERËSIMET PËR SHPRONËSIM									SHËNIME (kufizime hipotekare, barrë mbi pasurinë etj.)		
	Emri	Atësia	Mbiemri										Fshati ose qyteti	Z. kadastrale	Nr. i pasurisë	Lloji i pasurisë	Sipërfaqja totale	Arë (m²)	Trrall (m²)	Ndërtesë (m²)	Volumi		Faqe	ARË
				Sipërfaqja	Çmimi (lek/m²)	Vlera (lek)	Sipërfaqja	Çmimi (lek/m²)	Vlera (lek)	Sipërfaqja	Çmimi (lek/m²)	Vlera(lek)												
1	Thoma	Mihal	Gjergji	Kuçovë	2310	8/382	Godinë	39		39	39					39	2,040	79,560	39		908,683	988,243	Konfirmuar nga ASHK-ja	
2	Eftion	Viron	Bishka	Kuçovë	2310	8/369	Godinë	37		37	37					37	2,040	75,480	37		717,813	793,293	Konfirmuar nga ASHK-ja	
3	Ismail	Rushit	Kapuçi	Polovinë	2179	99/52	Ullishtë	30				8	70			30	268	8,040				8,040	Konfirmuar nga ASHK-ja Vlerësimi për pasuritë e llojit “ullishtë” është bërë bazuar në vendimin nr. 89, datë 3.2.2016, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë”, pasi në bazë të verifikimit të raport-vlerësimit në fakt të pasurive, nga subjekti kërkues, ka rezultuar, se pavarësisht që e kanë të shkruar në kartelën e pasurisë llojin e pasurisë “ullishtë”, rezulton se sipërfaqja e prekur nga shpronësimi, është sipërfaqe “tokë bujqësore”. Me shkresën nr. 822/1, prot., datë 9.6.2021, nga ASHK-ja, Drejtoria Vendore Kuçovë është përcaktuar që çmimi minimal fiskal për pasuritë e llojit “ullishtë”, në ZK 2179, është 268 lekë/m².	
4	Lili	Koçi	Çibuku	Polovinë	2179	99/44	Ullishtë	100				7	69			100	268	26,800				26,800	Konfirmuar nga ASHK-ja Vlerësimi për pasuritë e llojit “ullishtë” është bërë bazuar në vendimin nr. 89, datë 3.2.2016, të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë”, pasi në bazë të verifikimit të raport-vlerësimit në fakt të pasurive, nga subjekti kërkues, ka rezultuar, se pavarësisht që e kanë të shkruar në kartelën e pasurisë llojin e pasurisë “ullishtë”, rezulton se sipërfaqja e prekur nga shpronësimi, është sipërfaqe “tokë bujqësore”. Me shkresën nr. 822/1 prot., datë	
	Kristaq	Petraç	Çibuku																					
	Aleksandër	Nasi	Angjeliu																					

[illegible]